



Viti i njëmbëdhjetë i botimit, Mujore, Nr.12 (140) Tetor 2010  
 gazetamokra@yahoo.com Kryeredaktor: FLORI SLATINA  
 www.poradeci.com/mokra

ÇMIMI 20 LEKE

# Trebinja voton për kryetarin e ri

Për një drejtim sa më racional të komunës së Trebinjës, duhet një specialist me përvojë, që të njohë mirë sekretet e bujqësisë e te blegtorisë

## TREBINJA PËR KRYETARIN E PESTË

Nga Pëllumb ZADE

Që nga viti 1992, kur u bë riorganizimi i pushtetit lokal mbi bazën e komuneve dhe bashkive, Trebinjën e kanë drejtuar katër kryetar, të zgjedhur në pesë mandate. Kështu në vitin 1992 u zgjodh kryetar Përparim Kalanxhi nga PS. Në vitin 1997 u zgjodh Neki Laraku nga PD. Në zgjedhjet e vitit 2000 populli votoi Bujar Sofin nga PS, i cili e ushtroi detyrën edhe për një mandat tjetër, pasi fitoi edhe në vitin 2003. Në zgjedhjet e vitit 2007 u zgjodh Gjergji Buzo i PSD, i cili nuk e përfundoi dot mandatin, pasi u shkarkua nga kryeministri për korrupsion. Kryetari i zgjedhur më 24 tetor do të jetë i pesti për komunën e Trebinjës, me shpresën se do të jetë ndryshe nga të parët!

## Dhimbje, repekt, mall për Misto Markon

Nga Tomi MATO



## Somotina dhe Zëmça, Hondishti dhe Shëndpremtë në 2010-n

Panoramë e shkurtër e fshatrave që po braktisen dita-ditës

## KËRKIME PËR VENDBURIME ARI NË POGRADEC

Nga Rexho KURTI

# MOKRARËT E STAROVËS

Lista e kryefamiljarëve të ardhur nga komuna Velçan dhe Proptisht në Mokrën e Poshtme nga viti 1990 e deri në fund të vitit 2009, të vendosur në Starovë dhe fshatrat përreth



Nga Ramadan GJATA

Pas viteve 1990, ashtu si në gjithë Shqipërinë, filloi një lëvizje demografike e popullatës, duke zbritur nga zonat rurale në zonat urbane, në qendrat e mëdha, në zonat turistike dhe në vendet e ulëta. Fshatarësia po i braktis çdo ditë pronat e saj, të cilat nuk dihet se kur i ka pasur dhe që ato prona kanë mbajtur gjallë atë popullsi.

Në vitet e mëparshme (para 1990-ës), bëhej një propagandë që popullsia të shpërndahej në tërë territorin e Shqipërisë dhe që rinia duhej t'u qepej kodrave e maleve e t'i bënte ato pjellore si dhe fushat. Dhe ashtu u bë. Prodhi-

## Lufta civile në Dunicë – 7 Mars 1944

Lista e plotë e të pushkatuarve në Dunicë

LISTA E DISA TË PUSHKATUARVE NË RRETHIN E POGRADECIT GJATË REGJIMIT KOMUNIST, 1944-1991

Nga Bedri BLOSHMI



Ka shumë njerëz që duan të jenë si historianë për të shkruar të vërtetën e vërtetë se ç'ka ndodhur në Shqipëri gjatë viteve 1943-'44 në kohën e luftës civile, gjatë kësaj periudhe që shqiptari vrau shqiptarin nën thirrjen e urremtë se po luftojmë fashizmin.

PORTRET PËR HASAN BIBËN, BURRI SHEKULLOR I VELÇANIT, LEGJENDARI ME ZEMËR TË MADHE

## Duke punuar jeta kalon bukur

Nga Maliq TORRA



Shkak për të shkruar këto rreshta, për të portretizuar një nga fisniket zemërbardhë mokrarë nga fshati Velçan, është një telefonatë e largët nga Tirana. Nga celulari dëgjoj zërin e Sami Lekës, i cili më kërkonte një "nder" (siç më tha atë natë) për të shkruar një shkrim për një nga miqtë e tij më të nderuar Hasan Biba. "Nuk mund të vij vetë, më tha Samiu, - prandaj, të lutem, më bëj një nder, (faqe 3)

UDHËTIMI NË SHQIPËRI I GAZETARES FRANCEZE PAULE FERCOQ DE LESLAY  
 Nga Zenun FERRO

## Vallja e kapedan Fordinës

Tregim nga Istref HAXHILLARI

# Trebinja, votime për një kryetar ndryshe

Për një drejtim sa më racional të komunës së Trebinjës, duhet një specialist me përvojë, që të njohë mirë sekretet e bujqësisë e te blegtorisë

Nga Pëllumb ZADE

Zgjedhjet e parakohshme që do të zhvillohen në komunën e Trebinjës, për kryetarin e ri të saj, për mua kanë një rëndësi të veçantë, mbasi kjo komune është vendlindja si dhe vendbanimi për një periudhë mjaft të gjatë kohe dhe ndjehem shumë keq, kur shikoj sot, pas njëzet vjetësh demokracie, gjendjen e saj të mjeruar. Për 17 vjet rresht komuna është drejtuar në mënyrën më të keqe të mundshme nga e majta socialiste. Para dy tre ditësh, isha në Pogradec ku, rastësisht, takova një mikun tim, një intelektual të nderuar, por me bindje politike të majta i cili, në bisedë e sipër kur e pyeta nëse do angazhohej në këtë fushatë të parakohshme zgjedhore, pa e zgjatur më dha përgjigjen shkurt: "Jo" Kur e pa se përgjigja e tij nuk më bindi, vazhdoi me argumentet: "Unë kam qenë në disa fushata elektorale në zonën e Trebinjës, por si kandidat për deputet në zgjedhjet parlamentare, ashtu edhe në ato të pushtetit vendor, për kryetar komune. Edhe pse kanë fituar zgjedhjet, mua më vjen zor të shkoj përsëri aty, sepse nuk kanë bërë asgjë për rritjen e mirëqenies së atyre njerëzve të nderuar që banojnë e jetojnë atje. Madje ky i fundit na turpëroi fare, kështu që unë nuk kam me sy e faqe të shkoj e të bëj fushatë për një kandidat tjetër të majtë!" Argumentet e tij qenë mjaft bindëse e të vërteta. Komuna e Trebinjës ka qenë më e mira jo vetëm në Mokër, por edhe më gjerë. Ajo ka një terren kodrinor - malor të shtruar e një klime jo aq të ashpër, ku kulturat bujqësore e prodhimet blektoriale, perimet e frutoret kanë dhënë rezultate shumë të mira në vite. Të vjen shumë keq kur sot i gjithë vendi ka ecur para në të gjitha fushat, kjo komune jo vetëm që nuk ka bërë përmirësime, por e themi pa frike se ka bërë hapa mbrapa.

Mendoj se titullari i kësaj komune nuk ka pse të jetë një profesor apo doktor, shkrimtar apo artist. Aty duhet një specialist me përvojë drejtuese që të njohë mirë sekretet e bujqësisë e blektorisë, të njohë mekanikën bujqësore, të njohë e të



shkelë zonën në çdo pëllëmbë të saj geografike, si dhe të jetë një menaxher i aftë për t'i administruar me nikoqirllëk ato fonde, ndofta modeste që ka në dispozicion, cilësi këto që me sa e njoh unë, (e që nuk e njoh pak) i ka jo të pakta kandidati i për zgjedhur nga koalicioni PD-LSI, z. Feim Jasharlari, i cili ka një stazh pune e një përvojë të gjatë në sektorin e bujqësisë, në të gjithë kompo-

## ZGJEDHJET NË TREBINJË SHTOHET FONDI PËR KQZ-NË

Qeveria shton fondin në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me 1 milion e 542 mijë leke. Shtesa është bere për të mbuluar shpenzimet e zgjedhjeve në komunën Trebinjë të Korces ku në 24 tetor do të zgjidhet kryetari i ri i komunës. Keshilli i Ministrave vendosi që Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Trebinjë qarku Korçe me 24 tetor 2010 ti jepet një fond shtese prej 1 542 000 lekesh të ndare perkatësisht 542 000 leke për paga e sigurime dhe 1 000 000 leke për materiale e shërbime - thuhet në vendimin e qeverisë. Ky fond do të perballohet nga fondi rezerve i buxhetit të shtetit.

mentët e saj praktikë e shkencorë. Shpresoj dhe besoj se populli i asaj komune, më në fund e ka kuptuar se duhet ndërruar "kahu i zgjedhjes", siç thotë vetë mençuria e popullit. Një rol të rëndësishëm për ecjen para të komunës luan personi për të cilin ata do japin votën e do e zgjedhin për t'i drejtuar. Kam bindjen se z. Feim Jasharlari, me karakterin, autoritetin dhe aftësitë e tij të shumta profesionale, me ndihmën e gjithanshme të pushtetit qendror të PD, si dhe me ndërtimin e rrugës nacionale Qukës- Qafë- Ploçë, punimet e së cilës kanë filluar e po vazhdojnë, një rrugë që e përshkon komunën e Trebinjës në zemër të saj, do e ndryshojnë ndjeshëm jetesën për ata njerëz të varfër por shumë punëtorë e të ndershëm që jetojnë atje.

## Somotina në vitin 2010

Fshati Somotinë mbijetoi nga emigrimi dhe migrimi pas vitit 1990. si të gjithë fshatrat e Mokrës edhe somotina bën një jetë të thjeshtë, mes punëve, halleve dhe gëzimeve të përditshme. Në këtë fshat jetojnë sot 32 familje, me rreth 160-170 banorë. Banojnë 6 fise, si Topalli me 7 familje, fisi Elezi me 3 familje, fisi Belegu me dy familje, fisi Llapushi me 16 familje, fisi Bufi me 3 familje dhe fisi Kllogjeri me një familje. Fshati ka një shkollë fillore me 7-8 fëmijë dhe një kopsht me 6-7 fëmijë. Në fshat kalon rruga automobilistike Proptisht-Laktesh, furnizohet me ujë të pijshëm me orar, nga ujësjellësi i Mushatës, i ndërtuar para vitit 1990-të.

Ridvan LLAPUSHI

## UDHËTIMI NË SHQIPËRI I GAZETARES FRANCEZE PAULE FERCOQ DE LESLAY

Nga Zenun FERO



Gazeta "Ilyria" e vitit 1935 shkruan se Kontesha Paule Frecaq de Leslay, përfaqësuese e gazetës franceze "L'Intransigent" ndodhej në Tiranë. Më pas më 4 janar 1936, po kjo gazetë jepte njoftimin për kthimin e gazetës franceze nga udhëtimi i saj i 9-të i gjatë nëpër malësi. Ajo udhëtimin e filloi nga Shkodra, ku bleu dy kuaj dhe me qera pesë të tjrë. Zotërinjtë e kuajve si dhe një xhandar e shoqëronte atë në udhëtimin e saj. Përshkroi rrugën drejt Vermoshit, e mahnitur jo vetëm nga natyra por edhe nga kodet e jetës shqiptare e këtij "qytetërimi tremijë vjeçar, që ka rënë në gjumë magjik,, Pasi la Vermoshin shkoi në Pejë e pastaj zbrit drejt Drinit . Karvani shkon në Prizren, pastaj në Gjakovë, dhe karvani vazhdon udhëtimin përmes maleve , në grykat e lumenjve, në Pukë, Mirditë, Orosh. Kur zbrit në Lurë, ishte një ditë dasme, "Nusja mbuluar me duvak të kuq. Ajo tundej nën krismat e pushkëve. Në çdo shtëpi që kaloje, me luteshin e më ftonin që të qëlloja me armë edhe unë. Ç'udhëtim i lumtur, kur armën time e përdor vetëm për të përshëndetur miqtë e mi,, Është muaj i shatë i udhëtimit, dhe ajo gjendesh në malin e "Korabit, në lartësinë 2600 metra. Pamja e

parë e saj ishte e pabesueshme, kishite një gëzim fëmije. Larg shquhej maja e Tomorit, nga lindja fusha pjellore e Metalisë, akoma më shumë më larg Ohri, i cili shkumon ajo "që nga koha e Aleksandrit të Madh, nuk i ka ndryshuar format e barkave të Liqenit,, Për gazetaren Paule Fercaq de Leslay udhëtimi në jug ka të tjera ngjyra e imazhe. Në reportazhin e saj me titullin "Shqipëria e Jugut, tokë e rrënojave antike dhe pasurive të ardhshme,, ajo shkruan se ka qytete ku "ideja e unitetit kombëtar rri zgjuar,, etj. Përshtypje të veçantë ka për Korçën, të cilën e quan "Krenaria e intelektualëve Shqiptarë, apo Beratin" qytetin e dytë shqiptar për bukurinë, pas atij të Shkodrës. Në Apolloni ajo takohet me arkeologun francez Leon Rey. Pas kësaj vizitoi Butrintin, Finiqin dhe shkruan se invazionet romane, hormande, pushtimi i gjatë Osman, e kanë shkatër-

## Nënkolonel Dr. Jani BASHO, drejtori i parë i Spitalit Ushtarak



81 vjet më parë, pikërisht më datën 26 shtator 1929, aty ku sot është kirurgjia, pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" filloi funksionimin spitali i parë ushtarak në Shqipëri, në kuptimin e një spitali unik, me repartet kryesore dhe standartet e një spitali ushtarak bashkëkohor dhe modern për kohën. Drejtori i parë i spitalit ishte nënkolonel Dr. Jani Basho, lindur në Pogradec më 1892, i diplomuar shkëlqyeshëm me titull "Unicus Medicus Doctor" në Vjenë Austri, në degën e kirurgji-obstetrike. Pas kthimit në atdhe u emërua shefi i seksionit të shëndetësisë në Komandën e Mbrojtjes Kombëtare, drejtor i Spitalit Ushtarak (1925-1935), dhe mjek personal i Mbretit Zog. Dr. Jani Basho është një emër i madh i mjekësisë shqiptare, ushtarake dhe civile. Me emrin e tij lidhet ndërtimi i Spitalit Ushtarak dhe Spitali Civil me projekte që ai solli nga Vjena më 1927 dhe që janë projektuar nga arkitekti vjenez Kohler. Për ndërtimin e tij u shpenzuan 548.894.88 Franga ari. U nda jeta në vitin 1957.

Kolonel. Dr. Shkencash. Luan NIKOLLARI Epidemiolog. IKMU-SUQU

## ZEMÇA NUK I MBIJETOI DOT MIGRIMIT

Xhemal FERO

Ndryshe nga disa fshatra të tjerë, fshati Zemçë nuk i mbijetoi migrimit dhe emigrimit. Banorët u larguan thuajse pasivisht nga ky fshat, për arsye të infrastrukturës së dobët, kryesisht mungesës së rrugës, arsimit, mjekësisë. Nga mbi 80-90 familje që kishte fshati para vitit 1990-të sot aty jetojnë 5 familje, Xhevit Zeqollari është në pension dhe merret me blegtori, Selmani punëtor në mirëmbajtjen e rrugës, Petriti, edhe ai merret me blegtori, Hidriu po ashtu me

blegtori. Nga fshati Pleshisht ka ardhur në Zemçë, një djalë nga Kruja që ishte martuar në Pleshisht. Ai la fshatin Pleshisht dhe sot banon në Zemçë, tek ndërtesa e shkollës dhe merret me blegtori. Dy-tre fëmijë të Petritit shkojnë e bëjnë mësimin në Pleshisht. Fshati Zemçë nuk i mbijetoi dot migrimit dhe emigrimit. Me ndërtimin e rrugës së re Qukës-Ploçë, besoj se fshati do të rilindë, do të gjallërohet. Me këtë rrugë që është në projektet e qeverisë, besoj se do të gjallërohet e gjithë Mokra, në të ardhmen.

ruar jetën e fisit në jug, në favor të jetës në një komunitet më të gjerë. Ajo përmend Shqipëtrinë e shquar Mehmet Aliu, një nga figurat e historisë së Egjiptit të Vonë, flet për Ali Pashë Tepelenën, për regjimentin e shqiptarëve që luftoi përkrah ushtrisë së Napolonit Bonopartit e tjerë. Për këtë udhëtim të gjatë edhe të rrallë, shumë pak fakte e ngjarje janë

hedhur në reportazhet e botuara në të "Illustration", në vitin 1939. Forcaq, nuk u martua, por kishite veshjen e saj aventuroze, gjersa në moshë të thyer ishte tërhequr në një shtëpi të saj në Bell "Ile" një ishull në bregun perëndimor të Francës, në Atlantik. Atje në banesat private, vrasësit, pasi i morën gjithë byzylykët dhe rubinët, e vrasin.

- **ORARI I**
- **MIKROBUZAVE**
- **NË MOKËR**
- **Slabinjë- Pogradec -5.45**
- **Velçan- Pogradec -4.30**
- **Velçan- Prrenjas -6.00**
- **Bishnicë- Elbasan -7.00**
- **Pogradec- Slabinjë -6.00**
- **Pogradec- Slabinjë -12.00**
- **Pogradec- Velçan -12.00**
- **Prrenjas -Velçan -13.00**
-

PORTRET PËR HASAN BIBËN, BURRI SHEKULLOR I VELÇANIT, LEGJENDARI ME ZEMËR TË MADHE

# Duke punuar jeta kalon bukur

Nga Maliq TORRA

Shkak për të shkruar këto rreshta, për të portretizuar një nga fisniket zemërbardhë mokrarë nga fshati Velçan, është një telefonatë e largët nga Tirana. Nga celulari dëgjoj zërin e Sami Lekës, i cili më kërkonte një "nder" (siç më tha atë natë) për të shkruar një shkrim për një nga miqtë e tij më të nderuar Hasan Biba. "Nuk mund të vij vetë, më tha Samiu, - prandaj, të lutem, më bëj një nder, sepse atij burri i jam në borxh!" Eh, Sami Leka, - mendova unë, - bukur ke qëlluar. Po cili është ai velçanak dhe mokrar që nuk i ka borxh Canes së Kadriut?!

Fisnikeria e tij, bujaria e pashoqe e këtij legjendari, i ka kaluar kufijtë përtej Mokrës. Zemra e tij bujare ka pasur të shtruar sofrën e mikpritjes, për të njohur dhe të panjohur, për miq dhe për të ligj, për mokrarë dhe për jabanxhinj. Aty hante dhe zyrtari i dhjamur dhe pazaraku i vonuar nga Vërça. Aty ku ara e Gjëmthit krihej në qafën e krezave, ka lindur Hasan Biba (Canja i Kadriut) rreth një shekull më parë, një derë e madhe, me burra fisi të rrallë për nga muhabeti dhe nga bujaria. Gati njëqindvjeçar, por i palodhur si një tridhjetvjeçar, mbase krahasimi nuk është i gjetur sepse të shumtët e këtyre njëzet apo tridhjetvjeçarëve rrinë klubeve duke pirë votkë dhe duke bërë llogje pazari. Djaloshi njëqindvjeçar, Canja i Kadriut, i prin kopësë së bagëtive për kullotë deri lart në Gjëmth, ku ujët e



Hasan Biba, djathtas

ftohtë akull dhe era e ngjyer në rrëshirë pishe dhe bredhi, të kuron dhe të ripërtërin moshën e pleqërisë. Duart e tij të rreshkura dhe gishtërinjtë e tij të plasaritur nga puna e përditshme nuk e di pse me ngajnë me një njeri të ardhur nga mitologjia e largët. A mos Canja i Kadriut është heroi mitologjik i kohëve moderne, si dëshmitar real që kërkon të sfidojë ata që thonë se këtu nuk jetohej, se Shqipëria nuk bëhet...?!

Eja, o njeri i mbarë, e tako Canen e Kadriut, pastaj do të ndërrosh mendje mbi dilemat që ke mbi pamundësinë e përbalimit të vështirësive të jetës. Canja është një shkollë më vete që të mëson me punë e jo me llafe pazari apo llafe kafe-

nesh. Jeta e tij ka qenë pune dhe vetëm punë. Historitë e tij janë të shumta, por unë do të tregoj njerën nga ato që më ka bërë përshtypje më shumë kur e kam dëgjuar për herë të parë. Në Moker shokët dhe miqtë e Canes janë të shumtë por kjo ka ndodhur në Laktesh, në fisin Sariu. Në kohën e kooperativës njeri nga fisi i Sarinjve shkon për miqësi tek Hasani. Mbase ngrejnë e pijnë një doli miku del për nevojë personale në oborr, shikon aty një shqerr të vogël. Për të bërë shaka me Canen e kap shqerrën dhe e ther. Canja ngre një doli të dytë për aktin bujar që kreu miku. Mbas disa ditësh Canja i kthen vizitën mikut në Laktesh. Ngrejnë e pijnë doli

dhe Canja del jashtë për nevojë personale. Diku shikon lopën dhe bri saj një mezat, gati motak. Nxjerr biçakun dhe i heq kokën mezatit, i merr të brendshmet dhe me to në duar hyn në konak, ku vlon muhabeti dhe dollia mokrare. I zoti i konakut e merr me mend se mund të ketë bërë canga dhe i bie gota nga dora. "Qëndro, bre burrë, i thotë Cania, se burrit nuk i dridhet dora për një dëm!" Kjo hyn në shakatë e shumta me zarar por zarari më i madh ishte me njerëzit e sigurimit kur Cania u etiketua asaj kohe si njeri i rrezikshëm për pushtetin se therja e demit tregonte që ai ishte i pamëshirshëm dhe për regjimin. Eh Cane, Cane dhe operimi i kohëve të fundit nuk të gjunjëzoi (kohet e fundit Cania iu nëneshtrua një operimi të vështirë). Mosha gati shekullore ka lënë gjurmët e saj mbi trupin e Canes, por nuk ka mundur ta tjetërtojë dhe shpirtin bujar dhe hokatar, të rrahur nga era e ashpër e Gjëmthit, e zbutur fisnikërisht nga flladit dhe era e rreshirës së pishës dhe bredhit të pyjeve mokrare. Në këto pak rreshta nuk mund të jepet e plotë jeta e një njeriu të thjeshtë mokrar.

Do të duhen faqe të shumta për të pasqyruar sadopak përpjekjet dhe punën e palodhur të Canes të mbushur me virtyte dhe ndershmëri si rrallë tjetër në Moker e më gjerë. Ky është një nderim që i bëhet njeriut të palodhur dhe hokatar, njeriut që ka sfiduar kohën.

Tek fotoja treshe është ne mes dhe tek dushja i pari nga e djathta.

Velçan, shtator 2010

## KËRKIME PËR VENDBURIME ARI NË POGRADEC

Nga Rexho KURTI

Një pjesë të jetës dhe të punës sime e kam kaluar në rrethet Pogradec e Korçë, në krahinat e Mokrës e të Gorës, për të cilat do të mundohem të shkruaj diçka më shumë për punën dhe njerëzit, me të cilët kam njohur dhe kam punuar. Njohja me këto vende ka filluar në muajin prill 1967, ku së bashku me shokët e ekipit tim, që ishin pjesë e një ekspedite të mineraleve të rralla e të çmuara të ndërmarrjes gjeologjike Tiranë bëmë rikonicionin e parë në rrethin e Pogradecit, në përrrenjtë dhe lumenjtë e Mokrës e të Gorës. Më konkretisht puna filloi tek ura e rrugës automobilistike nacionale Leshnicë-Çërravë.

Pasi zbritëm mjetet e punës në shtratin e lumit, morëm provën e parë nga zalli i lumit dhe gjatë përpunimit sipas metodave të njohura vumë re se në fraksionin e rërës ishin të pranishme grimca ari me një përqëndrim që për atë kohë na u dukën se kishim të bënim me përqëndrime të vendburimeve të arit. Kjo punë vazhdoi për disa javë dhe muaj, jo vetëm në lumin e Çërravës, por edhe në përrrenjtë e Leminotit e të Çaushtisë, përrrenjtë e Vërdovës e Rrëmenjit, në rrjedhjen e sipërme të lumit Shkumbin, nga Proptishtit, deri në Kalivaç apo në afërsi të Gurit të Kamjes që tani është bërë simboli i krahinës Gorës dhe i shokatës "Gora". Objekt më i

rëndësishëm u kondiserua lumi i Çërravës, i cili e ka burimin në rrëketë e Gurit të Kamjes dhe më poshtë përshkron fshatrat Beragozhd, Stropckë, Leshicë, Çërravë e vazhdon deri sa del jashtë teritorit shtetëror poshtë fshatit Peshkëpi duke u derdhur në Liqenin e Ohrit disa dhjetra metra në veri të Shën Naumit. Formacionet prej nga buron edhe metali i çmuar janë të tipit sedimentar, të epokave të herëshme gjeologjike. Për punën tonë në vazhdim u hartuan projekte, të cilat u zbatuan gjata viteve 1968-1971. Në vitin 1969 në lumen e Çërravës u bë një çfrytëzim eksperimental, që nënkuptonte përpuminin e disa qindra ton m3 material lumor që kishte për qëllim të vlerësonte përmbajtjen e metalit të dobishëm. Për ta kthyer në objekt për shfrytëzim në këtë objekt kanë punuar rreth 50 punëtorë nga qyteti i Pogradecit. Në shtratin e lumit u instaluan disa dhjetra pajisje për fraksionimin e materialit, si dhe një tavolinë virbuese, që e ndante materialin sipas peshë



specifike. Produkti i përfitur nga ky shfrytëzim u ambalazhua dhe u dërgua në laboratorët e ndërmarrjes për veçimin e arit nga pjesa tjetër e fraksionit të rëndë. Në raportin e hartuar pas kryerjes së kësaj detyre u theksua se lumi i Çërravës është objekt që mund të çfrytëzohet në kompleks pra si material ndërtimi dhe krahs tij të veçohet fraksioni i rërës dhe nxjerrja e arit prej tij. Vite më vonë ndërmarrja e ndërtimit në Pogradec ngjiri në shtratin e lumit Çërravë poshtë fshatit, një nyje inertesh ku u shfrytëzuan disa mijëra m3 zavorishte. Ekipi gjeologjik u vendos me banim në fshatin Çërravë, pranë rrugës automobilistike, në një godinë modeste pranë së ciles hapi një pus për të plotësuar dy qëllime, për kërkim në depozitimet e vjetra dhe për sigurimin e ujit të pishëm i cili ishte një problem i veçantë për kohën që flasin. Ekspozita zhvilloi punime kërkimore edhe në përrrenjtë e Leminotit e të Çaushtisë, që kishin karakteristika të përafërta me ato të Çërravës. Në fund të kujtimeve të mia dua të përmend për krahsjen dhe ndihmën e autoriteteve të vendit e cila ka qenë e pakursyer, si për jetesën tonë ashtu edhe për plotësimin e nevojave të tjera për të kryer detyrat.

LIBRI SHQIPTARO-AMERIKANIT JAMES W. PANDELI. "OH SHQIPËRI,, SHQIPËRIA IME E MJERË,,

## Fillimi i botës është burimi i Shkumbinit

Nga Zenun FERO

Historiani shqiptaro-amerikan James W. Pandeli, në vitin 1980, botoi librin "Oh Shqipëri, Shqipëria ime e mjerë,, duke zbërthyer një pjesë të gjenezës së historisë të popullit ilir, që prej vitit 700, para Krishtit. Libri i është dhënë misionit shqiptar në OKB, në 1 prill 1980, dhe në muajin mars 2010 është botuar në Kosovë. Zoti Pandeli ka pasur dëshirë të madhe për të shkruar historinë e prejardhjes, vazhdimësisë pellazgo-iliro-shqiptare. Shumë fakte të rëndësishme i dëllin, kur lexonte "Gjeneza e zotërve,, të Hesiodit në vitin 700 para Krishtit, dhe kjo e shtyri të mendonte se ç'duhet të bënte. Një fakt shumë interesant në histori është shkruar nga vetë Hesiodi për perëndeshën Afërditë, simbol i dashurisë dhe mbarësisë. Në vitin 1979, zoti Pandeli, shqiptar-amerikan shkoi në bibliotekën e Ft. Lauderdale, Florida dhe po lexonte Hesiodin, dhe mbante shënime. Në këtë i bën pyetje vetes: "A mund të jetë sipas versionit të lashtë se fillimi i Botës ishte lumi i Shkumbinit?! Kjo mund të mos ketë qënë fakti i një fillimi, por këto teza mund të jenë hedhur që në lashtësi, nga gojëdhënat e banorëve të kësaj zone. Në bibliotekë, merr një libër gjeografik, dhe ishte vërtet e befasishme e habitshme gjetja e emrit të vjetër të lumit, i cili ishte "Genusus,,. Aty Pandeliu kuptoi se çfarë zbuloi. Ky emer i lashtë ishte një pjesë dhe fakt i historisë. Një pjesë që së



bashku me të tjerat japin një ide të mundshme. Shkrimi i Hesiodit shihet tashmë me një tjetër këndvështrim. Njerëzit kanë evoluar që në kohët e lashta në rrethinat e Shkumbinit, aty ku ka filluar jeta njerëzore primitive. Nuk mund të përfytyrojmë këtë kohë primitive, por sipas zotit Pandeli mund të reflektojmë duke shfrytëzuar idetë dhe tezat e ndryshme, perceptimet, faktet, gjuha, fjala dhe emrat që i kanë mbijetuar gjithmonë evolucionit.

Historiani jep një mesazh për shqiptarët. "Shqiptarët janë muze i gjallë i kulturës në botë,,

Gjithçka unë e bëra, për të hapur një dritare për të kuptuar se ç'është origjina. Qeramikat më të lashtat janë gjetur në Shqipëri dhe shpjegojnë pasaktësitë.

Libri i Pandeliut, sjell një këndvështrim të ri deri tani të paimagjinuar, jo të ndërtuar mbi të pavërteta, por për të dhënë të vërtetën. Të huajt kurrë nuk kanë mundur të na studiojnë në thellësi të ekzistencës sonë, se kanë qenë të shtyrë nga interesat e tyre. ADN-ja shqiptare ka qenë e pranishme që në lashtësi.



Nga Ramadan GJATA

# Mokrarët e Starovës

Lista e kryefamiljarëve të ardhur nga komuna Velçan dhe Proptisht në Mokrën e Poshtme nga viti 1990 e deri në fund të vitit 2009, të vendosur në Starovë dhe fshatrat përreth

Pas viteve 1990, ashtu si në gjithë Shqipërinë, filloi një lëvizje demografike e popullatës, duke zbritur nga zonat rurale në zonat urbane, në qendrat e mëdha, në zonat turistike dhe në vendet e ulëta. Fshatarësia po i braktis çdo ditë pronat e saj, të cilat nuk dihet se kur i ka pasur dhe që ato prona kanë mbajtur gjallë atë popullsi.

Në vitet e mëparshme (para 1990-ës), bëhej një propagandë që popullsia të shpërndahej në tërë territorin e Shqipërisë dhe që rinia duhej t'u upej kodrave e maleve e t'i bënte ato pjellore si dhe fushat. Dhe ashtu u bë. Prodhimi u rrit, popullsia u shtua, puna ishte e detyruar dhe lëvizja e kufizuar nga ligjet e vendosura nga pronari, i cili në këtë rast ishte shteti. Prona njihet si pronë e gripit dhe mjetet e prodhimit ishin pronë e punëtorëve dhe e fshatarëve. Prodhimi, në përgjithësi, u rrit, sepse pronari investonte me kredi dhe u bë bashkëpronar me fshatarësinë. Gradualisht, fshatarësia u shpronësua në kohën kur kapitalet e investimeve u bënë të barabarta me pronën e kooperativistëve. Tani fshatarët u bënë proletarë sepse me Kushtetutën e vitit 1976 çdo gjë u shpall pronë e shtetit: tokat, pyjet, kullotat, ujërat, pasuritë, pasuritë nëntokësore e mbitokësore dhe fshatarëve u njihet si pronë private vetëm shtëpia (hoteli) dhe prona e të ardhurave nga puna ditore që nuk linte tepriç. Atëherë bëhej një propagandë që fshatin ta bëjmë si qytetin: T'i sigurohej jetesa, t'i sigurohej buka, drita elektrike, t'i krijoheshin objekte social-kulturore si furra buke, çerdhe, kopshte, shkolla për edukimin e fëmijëve, qendra shëndetësore me mjekë e infermiere, shtëpi kulturore e vatra kulturore, duke krijuar grupe artistike amatore për teatrot dhe estradat për argëtimin e popullatës. Krahas informacioneve që jepte shtypi, radioja e televizioni, qarkullonte edhe filmi në mënyrë ambulatorie. Pronari (shteti) kishte filluar gradualisht të shfrytëzonte pasuritë nëntokësore e mbitokësore si minierat, pyjet, burimet ujore e të tjera dhe fuqinë punëtore e kooperativiste e kalonte në këto sektorë shtetërorë. Kështu pra, punën e bënte të detyruar dhe lëvizjen të kufizuar sipas një plani të caktuar dhe për çdo gjë përgjigje ai.

Pas viteve '90, kur duhej të ndërrohej pronari i mëparshëm (të ndërrohej sistemi politik) dhe të krijohet sistemi i ri politik (i demokracisë) ideatorët e sistemit i veshën shumë të meta sistemit të mëparshëm si: "Varfërinë", "lëvizjen jo të lirë", "punën e detyruar" e shumë të tjera dhe u interesonte të ndiqnin politikën e rrafshimit, të shkatërrimit të së kaluarës si në fshat edhe në qytet, duke shkatërruar si mjetet e punës ashtu edhe objektet e punës. Në këtë periudhë tranzicioni pronarët e rinj, që po vinin në të ardhmen në pushtet, propagandonin për një jetë më të mirë, duke përdorur sloganet: "Shqipëria si Evropa", "Shqipëria e izoluar", "Të shkojmë në Evropë", të hyjmë në NATO etj. Pronarëve do t'u kthejmë pronat si në fshat ashtu edhe në qytet, të cilat ua kishte marrë sistemi i mëparshëm dhe, indirekt ose direkt nxisnin politikën e shkatërrimit të çdo gjëje të mëparshme si dhe të grabitjes së pasurisë së përbashkët. Ndërsa shteti "formal" qëndronte indiferent ndaj të gjitha veprimeve të paligjshme.

Shteti i ri, i porsaardhur në fuqi, duke abuzuar me Kushtetutën e vitit 1976, ku çdo gjë ishte shpallur pronë e shtetit, dhe sot po ashtu, nxori paketën ligjore, në fillim,



Zyrat e komunes se Staroves

që prona të ndahej jo sikurse e kishin fshatarët para vitit 1945, ndoshta qëkur janë vendosur pronarët e parë në Mokër e gjetkë, por t'u jepej fshatarëve jo sikur u futën në kooperativë, por nga një rriskë për frymë pranë qendrave të banuara në fshat, duke mos u njohur atyre pronën në periferi të fshatit si arat bujqësore, kullotat, pyjet e zonës së dushkut, ku fshatarët i kanë zotëruar, ruajtur, rritur e i kanë shfrytëzuar si kullota për blegtorinë, si lëndë ndërtimi për nevojat e tyre me qindra vjet. Këto prona kanë mbajtur gjallë fshatarësinë. Kështu pra, duke u shkatërruar çdo gjë nga e kaluara si mjetet e punës po ashtu edhe objektet social-kulturore, duke mos u njohur edhe pronën ashtu siç u propagandua në fillim, fshatarëve ua bënë jetën shumë të vështirë. Në këtë kontekst, si punëtorët ashtu edhe fshatarët po mendonin për të ardhmen e fëmijëve të tyre, që t'u krijonin kushte jetese më të mira dhe, duke qenë të lirë, filluan emigracionin, për të siguruar parë më shumë dhe pasuri të tjera. Kështu pra, filloi lëvizja demografike e popullsisë në mënyrë të pakontrolluar. Kështu filloi edhe shpërndarja e Mokrës dhe i zonave të tjera rurale, duke zbritur në qytete të mëdha si në Tiranë, Durrës, Elbasan, në zonat bregdetare (turistike), në zonat e ulëta fushore etj. dhe zunë punë të pronarët e rinj, duke u paguar me mëditje. Kjo reformë, për t'i lënë fshatarët dhe punëtorët të lirë, u interesonte edhe politikantëve të rinj, sepse mendonin se së shpejti ata do të bëheshin pronarë dhe u duhej fuqi punëtore e lirë.

Nga një studim real i bërë në fshatin Starovë të komunës Buçimas të rrethit të Pogradecit, në konsultim edhe me kryefamiljarë, të cilët banojnë në fshatin Starovë, si Alush Balliu, Sherif Meçe, Haxhi Çane, Flamur Bego, Isuf Bego etj. me të cilët mundëm të evidentojmë se vetëm nga komuna e Velçanit dhe Proptishtit të Mokrës kanë zbritur në fshatin Starovë 117 familje me 658 banorë, nga të cilët 281 banorë, që përbëjnë rreth 43-44 për qind, janë emigrantë. Nga këta, rreth 70 për qind jetojnë e punojnë në Greqi; 20 për qind në Itali; rreth 10 për qind në Angli, Gjermani dhe Amerikë. Këtu nuk përfshihen banorët e ardhur nga këto dy komuna të Mokrës në fshatrat Verdovë, Rëmenj, Zërvashë e Zogorcan, që mund të jenë po aq banorë për secilin fshat dhe që janë banorë të kësaj komune. Të gjithë këta banorë po përipiqen të integrohen me banorët vendas. Ata janë lidhur me miqësi të vjetra, me lidhje martesore të vjetra e të reja, me vizita të njëri-tjetri nëpërmjet gëzimeve e hidhërimeve, nëpërmjet festive të tjera. Pushteti vendor bën trajtime pa dallime, madje mjaft prej të ardhurve punojnë në administratë; të tjerët trajtohen si vendasit në shërbimet e infrastrukt-

turës të komunës brenda mundësive dhe vendeve të punës e tjera.

Banorët e ardhur në fshatin Starovë janë kryesisht nga fshatrat Velçan 19 familje me 95 banorë, 41 banorë në emigracion; Slabinjë me 35 familje, me 181 banorë, nga të cilët 71 janë emigrantë; Serrishti 5 familje, 28 banorë, 13 në emigracion; nga Slatina e Verri Slatina 7 familje me 55 banorë, 20 në emigracion; Rodokali i Poshtëm 5 familje me 34 banorë, nga të cilët 7 janë emigrantë; Lakteshi 5 familje me 27 banorë, 19 në emigracion; Losniku 14 familje me 72 banorë, 57 në emigracion; Homeshti 9 familje me 49 banorë, 28 në emigracion; Selca e Poshtme 9 familje, 45 banorë, 10 emigrantë; Goliku me 2 familje, 10 banorë, 1 në emigracion; Homçani 4 familje, 25 banorë, nga të cilët 5 janë emigrantë.

Të gjitha këto familje, me punën e djersën e emigrantëve të cilët punojnë jashtë shtetit, kanë rikonstruktuar shtëpitë e blera nga vendasit. Sipas një llogarie, rreth 70 për qind e banesave janë të reja dy e trekatëshe; rreth 20 për qind janë të rikonstruktura nga banorët, e blera prej vendasve të cilët janë shpërngulur në qytete të mëdha, ose kanë ndërtuar banesa në tokat bujqësore të përfituara nga paketat ligjore të dhëna nga shteti. Pjesa tjetër, rreth 10 për qind, janë banesa në ndërtim ose sipërfaqe toke të projektuara për ndërtim nga emigrantët. Por si këto familje, të cilat kanë lënë shtëpitë e tyre në Mokër dhe janë vendosur në komunën e Buçimasit (Starovë), kanë ardhur edhe në fshatrat e tjera të kësaj komune si në Verdovë, Rëmenj, Gështenjas e Zagorcan. Po të marrim edhe lëvizjet e tyre demografike, si komuna e Trebinjës që ka më tepër fshatra se dy komunat që përmendëm më lart, të cilat janë të vendosura sit ë parat, mund të bëhen rreth 1000 familje, duke përfshijtur qytetin e Pogradecit ku numri i familjeve të Mokrës mund të jetë edhe më i madh. Po ashtu edhe në rrethet e tjera. Kështu, gradualisht, Mokra po shpopullohet.

Kjo braktisje në masë e pronësisë të fshatarëve në Mokër, në përgjithësi, në zonat rurale në Shqipëri, të kujton për analogji Rusinë cariste rreth 150 vjet më parë, andej nga mesi i shekullit 19, në vitet 1860, kur Rusia cariste, me sistemin e saj feudal bëri reformë dhe hoqi bujqërorë dhe i la fshatarët bujq të lirë. Kjo reformë u krye në interes të borgjezisë që sapo kishte filluar të zhvillohej në Rusinë cariste dhe në interes të feudalëve të mëdhenj, sepse të dyja palët deshën forca të lira pune dhe të paguanin pak. Kështu filloi të zhvillohej industria e bujqësia kapitaliste në Rusi. Në këtë mënyrë, fshatarët e lirë i braktisën tokat e pronarëve dhe u bënë punëtorë proletarë me mendimin se duke ikur nga feudalët do të fito-

nin parë, do të vinin pasuri e do të bëheshin pronarë, jo si më parë, bujkrobër. Por kjo ëndërr nuk iu plotësua fshatarëve proletarë, sepse ata shpëtuan nga bujkrobëria, por ranë në prangat e borgjezisë dhe të feudalëve të mëdhenj. Vërtet në atë kohë zhvillimi industrial i Rusisë u rrit, por me fuqinë punëtore të fshatarëve dhe me investimet e kompanive të huaja perëndimore si të Anglisë, Gjermanisë, Francës, të cilat ishin të zhvilluara më parë se Rusia. Por kjo zhvendosje demografike e fshatarësisë u përqendrua në qytetet e mëdha si në Moskë, Petrograd etj. U shoqërua me pasoja e vështirësi të reja si mungesa e banesave, kriza ekonomike, që çuan herë pas here në përplasje mes punëtorëve fshatarë e rendit në fuqi, derisa sollën kriza të thella ekonomike nga zhvillimi e prodhimi spontan. Kështu, ashpërsimi i kontradiktave u thellua derisa filloi Lufta e Parë Botërore dhe kështu ëndërra e fshatarëve dhe e punëtorëve të Rusisë nuk u realizua. Lufta e Parë Botërore mobilizoi rreth 14 milionë ushtarë për të përballuar vendet agresive siç ishin Gjermania, Austro-Hungaria, Bullgaria etj. Ndërsa tokat e lëna nga fshatarësia ose përvetësoheshin nga feudalët e mëdhenj ose tokat e lira bliheshin. Kështu u abuzua edhe me tokat e lira.

Tani le të vijmë te reforma jonë e bujqësisë e kudo. Braktisjen e pronësisë të fshatarët tanë i krijoi premisat shteti ri me paketat ligjore, me kushtetutën e re. ai jo vetëm i la bujq të lirë dhe punën e lirë, duke krijuar vështirësi të reja jetese, të cilat i përmendëm më lart. Ata (fshatarët) vërshuan drejt qyteteve të mëdha si në Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Pogradec dhe në vendet e ulëta si në Myzeqe e në bregdetin e në vendet turistike, pa menduar se çfarë vështirësish të reja jetese e banimi do të krijoheshin, sepse vendi ynë nuk ka industri, nuk ka fabrika e po ashtu edhe bujqësi, sepse në çdo gjë u ndoq politika e rrafshimit dhe të gjithë të nisemi nga një start. Kështu, fshatarët tanë që punojnë në qytete në ndonjë firmë ndërtimi, paguhen lirë ose bëjnë ndonjë punë të rëndomtë. Në vendet ku janë vendosur, nuk ka toka të lira; ata blejnë nga 200-500 m<sup>2</sup> sa për ndërtimin e një banese. Vende pune nuk kanë, sidomos familjarët që kanë ardhur në Starovë. Shteti ynë i ri la lëvizjen e lirë për fshatarët dhe punëtorët, hapi kufijtë dhe u tha: shkoni ku të doni. I orientoi drejt emigrimit që t'i shërbejnë zhvillimit të industrisë dhe bujqësisë së Greqisë, Italisë, Maqedonisë e vendeve të tjera të Evropës. Kurse familjet e prindërit (pleq) banojnë të vetmuar në banesat e reja. Ata nuk kanë prona, por mundohen të integrohen me banorët vendas duke marrë ndonjë copë toke me qira, kurse disa nga pensionistët që kanë mall për vendlindjen, gjatë verës shkojnë në fshat e mbledhin ndonjë prodhim që kanë pranë shtëpive të vjetra si kumbulla, dardha, rrush, mbjellin fasule a patate dhe kthehen e i konsumojnë gjatë dimrit. Ndërsa fëmijët e tyre jetojnë e punojnë larg familjes (në emigrim).

(Në qoftë se fshatarët (punëtorët) rusë u larguan nga tokat e feudalëve, ata shkuan e ndërtuan industrinë e bujqësinë e vendit të tyre, kurse fshatarët e punëtorët e vendit tonë ikën e po ndërtojnë industrinë e bujqësinë e vendeve fqinje. Kjo lëvizje e madhe e popullatës, në parim ka sjellë edhe zhvillim, sikurse e përmenda edhe më lart, se banorët e zbritur si në Starovë e kudo, kanë bërë banesa të reja me punën e emigrantëve, kanë sjellë makina luksoze. Por banesat e reja në përgjithësi janë të palegalizuara. Në përgjithësi, ato janë ndërtaur pa leje e në



toka bujqësore, jashtë planit urbanistik, atje ku fshatarët shisnin tokën.

Një pjesë e ndërtimeve, sidomos ato pas shkurtit të vitit 2007, ku pranë administratës së komunës Buçimas, u krijua një seksion dhe u ka dhënë leje ndërtimi të banesës duke paguar një vleftë në lekë sipas sipërfaqes së katit, të cilat mund të quhen të legalizuara. Ndërsa të gjitha të tjerat janë të palegalizuara. Shteti ka folur mjaft për legalizimet në periudha fushatash, por vetëm kohët e fundit po shikojmë në shtyp lista legalizimesh në qarqe të ndryshme sidomos në Tiranë, duke paguar tarifa ndërtimi pa leje. Sot, në median e shkruar e televizive bëhet një propagandë e madhe dhe e bujshme se “së shpejti pronarëve do t’u kthejmë tokat; do t’i shpërblejmë pronarët; do t’i kompensojmë pronarët; “do t’u njohim pronat” e shumë të tjera. Por, për njohjen e pronësisë duhen një mori dokumentesh, të cilat janë të pamundura të realizohen sepse kërkojnë shumë shpenzime. Por duhet thënë e vërteta lakurike, se ka 20 vjet që prona po shpërdorohet, po shitet e blihet nga vetë ideatorët e sistemit të ri, të cilët veprojnë në emër të shtetit. Shumë premtime u janë bërë edhe të përndjekurve si për detyra në pushtet edhe për shpërblime, por ata nuk kanë fituar ndonjë gjë të madhe veçse disa letra me vlerë e ndonjë vizë lehtësuese për të shkuar jashtë shtetit, ndërsa në pushtet janë të rrallë dhe më parë janë shpërblyer më parë ata që kanë qenë më afër “piramidës”.

Sot e 20 vjet më parë bëhet një bujë e propagandë e madhe për plotësimin e kushteve për *ëndrrën evropiane* si: lufta kundër trafikëve të qenieve njerëzore, kundër trafikimit të drogës, kundër krimit të organizuar, për ruajtjen e kufijve. Flitet për sigurimin e vendeve të punës, për luftimin e varfërisë; flitet me të madhe për luftën kundër korrupsionit me tolerancë 0, për uljen e amoralitetit e prostitucionit e shumë e shumë të tjera. Por të gjitha këto në vendin tonë sot janë prezent. Populli voton se rron me shpresë nëpërmjet propagandës tymuese çdo ditë e orë në RTV e në shtypin e përditshëm dhe ndihet tepër i lodhur sepse po vëren se ato që thuhet nuk bëhen realitet ose vonohen

tepër. Po të marrim vetëm rrugën Qukës – Qafëpulloç dhe rrugën Qafë Thanë – Pogradec po afron gati një vit e punimet kanë ngelur në mes. Kjo e bën të pabesueshme propagandën dhe kështu mund të themi se në qendër të atdheut janë mbledhur ideatorët e sistemit të ri ca nga njëra anë e ca nga ana tjetër, duke thirrur e bërtitur se ne jemi shpëtimtarët, ne do ta rrëzojmë hënën; pala tjetër thotë se ne do të bashkojmë qiellin me tokën e të tjera premtime boshë dhe vazhdohet kështu me mashtrime. Sepse çdo gjë është bërë me monopole e elitës. Ata janë vënë në shërbim të monopoleve të huaja dhe kompanive që investojnë në Shqipëri derisa të bëhen bashkëpronarë me pasuritë e Shqipërisë dhe atëherë do të humbasë edhe pavarësia e vendit.

Lidhur me bujën që bëhet në radio, televizion e shtyp e kudo tjetër në të cilat tjetër thuhet e tjetër bëhet, populli rron me shpresë dhe humbet shpresën. Kjo mund të krahasohet me një periudhë të viteve 1920-1924, ku i madhi Fan S. Noli e përmbledh në disa vargje në poezinë e tij “Krishti me kamxhik”, për të cilat mendojmë se janë aktuale edhe sot dhe nuk kanë nevojë për koment. Lexuesi do të dijë vetë të analizojë edhe analogjinë që kanë ato vargje me politikën e sotme:

*Në kështjellë të atdheut, në tempullin e fesë  
Janë shtruar sarafët e pashpirtë e pa besë  
Tregtojnë, gënjajnë rrëmbejnë e shfrytëzojnë  
Shtrembërojnë kanunet e marrin në dorë  
Dhe shkëlqejnë në kishë e në fron me kurorë  
Vegjelia për ta batërdisen e vriten  
Dhe kështu parazitët po rriten...  
Çdo i shtrenjtë ideal, çdo shtëpi perëndie  
Ishte bërë dyqan dhe Pazar tregtie  
Kush fiton më tepër, ai është usta  
Dhe kush nuk plaçkiste, ishte krejt budalla.  
Cilido lexues e bën vetë analizën e të madhit Fan Noli.*

Shoqata “Pelioni” dega e Pogradecit, ka organizuar shpërndarjen e leximin e gazetës “Mokra” edhe me komunitetin e Starovës. Më poshtë po japim edhe listat e kryefamiljarëve të ardhur nga komuna e Proptishtit dhe të Velçanit në fshatin Starovë.

**Shënim:** Të dhënat janë deri në dhjetor 2009. Të na falë ndonjëri që edhe mund ta kemi harruar.

**LISTA E KRYEFAMILJARËVE TË ARDHUR NGA KOMUNA VELÇAN E PROPTISHT NË MOKRËN E POSHTME NGA VITI 1990 E DERI NË FUND TË VITIT 2009:**

NR	Emri, Atësia, Mbiemri	Fshati	60.	Vërr	Slatinë
1.	Neki Alush Çela	Velçan	61.	Haki Idriz Alla	- “ -
2.	Gëzim Neki Çela	- “ -	62.	Xhemal Banush Mara	Slatinë
3.	Besnik Neki Çela	- “ -	63.	Ibrahim Elmaz Mara	- “ -
4.	Fezo Ibrahim Shtogu	- “ -	64.	Nazmi Banush Mara	- “ -
5.	Alfred Fejzo Shtogu	- “ -	65.	Osman Elmaz Mokrezi	- “ -
6.	Thanas Fejzo Shtogu	- “ -	66.	Agron Arif Leka	- “ -
7.	Shaqir Rexhep Lushta	- “ -	67.	Safet Selami Xhyra	Rrodokal
8.	Hetim Çela	- “ -	68.	Sami Muharrem Merkola	- “ -
9.	Shefki Rexhep Karasali	- “ -	69.	Ibrahim Isuf Mertkola	- “ -
10.	Ismail Rexhep Karasali	- “ -	70.	Fatmir Demir Jolla	- “ -
11.	Qani Selim Biba	- “ -	71.	Safa Faik Nafulla	- “ -
12.	Qani Dervish Biba	- “ -	72.	Sabri Mani	Laktesh
13.	Rakip Sejdin Hyka	- “ -	73.	Agron Kodhel Sari	- “ -
14.	Fatime Hyka	- “ -	74.	Pali Nexhat Gjona	- “ -
15.	Jace Shefki Karasali	- “ -	75.	Zybe Hajro	- “ -
16.	Agim Shefki Karasali	- “ -	76.	Ameli Kodhel Sari	- “ -
17.	Adrian Sejdin Hyka	- “ -	77.	Haxhi Nazif Cani	Losnik
18.	Sadi Bektash Shuli	- “ -	78.	Nazif Haxhi Cane	- “ -
19.	Nefail Nexhip Biba	- “ -	79.	Fuat Haxhi Cane	- “ -
20.	Ramadan Gani Bego	Slabinjë	80.	Drilon Haxhi Cane	- “ -
21.	Isuf Gani Bego	- “ -	81.	Kastriot Haxhi Cane	- “ -
22.	Qemal Zyfir Balliu	- “ -	82.	Halim Shahin Dervishi	- “ -
23.	Agush Agush Balliu	- “ -	83.	Sali Ali Dervishi	- “ -
24.	Burjam Agush Balliu	- “ -	84.	Sheme Baftjar Xhelo	Losnik
25.	Besim Bajram Balliu	- “ -	85.	Esat Xhelo Xhelo	- “ -
26.	Ramiz Bajram Balliu	- “ -	86.	Kurt Vesel Musaraj	- “ -
27.	Bashkim Bajram Balliu	- “ -	87.	Ferit Vesel Musaraj	- “ -
28.	Bujar Bajram Balliu	- “ -	88.	Osman Hysen Lamo	- “ -
29.	Ilir Bajram Balliu	- “ -	89.	Luan Ramiz Cano	- “ -
30.	Ferit Bajram Balliu	- “ -	90.	Festim Isa Ademi	- “ -
31.	Xhevahir Bajram Balliu	- “ -	91.	Sherif Beqir Meçe	Debrovë
32.	Lefter Bajram Balliu	- “ -	92.	Dritan Sherif Meçe	- “ -
33.	Xhevat Faslli Balliu	- “ -	93.	Mustafa Rahman Bajrami	- “ -
34.	Livan Fero	- “ -	94.	Beqir Sheme Korça	- “ -
35.	Rushan Seit Fero	- “ -	95.	Genc Ramadan Meçe	- “ -
36.	Hyrjet Seit Fero	- “ -	96.	Seladin Muharrem Çallni	Homezh
37.	Naim Ali Balliu	- “ -	97.	Gani Muharrem Çallni	- “ -
38.	Fadil Ali Balliu	- “ -	98.	Mand Petrit Gjata	- “ -
39.	Murat Abdyl Balliu	- “ -	99.	Muharrem Rakip Menkshi	- “ -
40.	Vait Sali Sinani	- “ -	100.	Nevruz Xhaferr Menkshi	- “ -
41.	Oran Bido Balliu	- “ -	101.	Lirim Shefqet Gjata	- “ -
42.	Enver Nexhat Gorrica	- “ -	102.	Fatmir Shefqet Gjata	- “ -
43.	Sefer Idriz Çela	- “ -	103.	Belur Shefqet Gjata	- “ -
44.	Reshat Idriz Çela	- “ -	104.	Lirie Muharrem Gjata	- “ -
45.	Faik Idriz Çela	- “ -	105.	Seit Riza Baçi	Selcë e Poshtme
46.	Rasim Idriz Çela	- “ -	106.	Pasho Seit Baçi	- “ -
47.	Mirash Idriz Çela	- “ -	107.	Haxhi Seit Baçi	- “ -
48.	Suat Idriz Çela	- “ -	108.	Xhemil Xhavit Dika	- “ -
49.	Barrus Bektash Bego	- “ -	109.	Neki Dika	- “ -
50.	Albert Dilaver Bego	- “ -	110.	Xhevahir Dika	- “ -
51.	Safet Dilaver Bego	- “ -	111.	Genc Gani Xhyra	- “ -
52.	Baftjar Agim Balliu	- “ -	112.	Nazif Gani Xhyra	- “ -
53.	Xhevat Bego	- “ -	113.	Munir Maliq Xhyra	- “ -
54.	Flamur Xhevat Bego	- “ -	114.	Hymet Ferit Progri	Homezh
55.	Alush Maliq Balliu	Senisht	115.	Pëllumb Seit Kombolli	- “ -
56.	Isa Ismail Balliu	- “ -	116.	Vezir Selim Komolli	- “ -
57.	Mersin Brahim Çollaku	- “ -	117.	Zalo Xhaferi	- “ -
58.	Ramiz Haxhi Çollaku	- “ -	118.	Seladin Refat Kapri	Golik
59.	Osman Hysen Isufi	- “ -	119.	Genc Sul Kapri	- “ -

**NJË HISTORI E SHKURTËR E FSHATIT HONDISHT**

Nga Nazmi JAHOLLARI

Fshati Hondisht është krijuar nga disa familje të ardhura nga Kavaja. Erdhën 6 familje nga Kavaja dhe ndërtaun shtëpi në Hondisht, aty kishin pak tokë. Për këtë i kërkuan kishës së Llëngës, që t’u jepete tokë, por kjo nuk i dha. Bënë ankesë në patrikanën e Ohrit, edhe atje, kisha e Llëngës, prifti nuk pranoi t’u jepete tokë, më shumë.

U kuptua në këtë takim se zgjerimi tokës do të zgjidhesh me forcën e armëve. Kur prifti i Llëngës kaloi në Hondisht u qëllua në kalë me pushkë shqiptare, me një mbushje. Roja i priftit qëlloi me armë, por personat u larguan shpejt. Prifti u plagos dhe nga këto plagë u nda

nga jeta. Per këtë u bë hakmarrja, u muar një plak, Zeqo dhe u pushkatua me forcë. Zeqo u pushkatua në majë të Hondishtit dhe nga rrjedhin ujërat poshtë është Hondisht, nga ana tjetër është e Llëngës.

Hondisht ka qenë tokë e kishës së Llëngës. Edhe sot ka emra krishterë, si ara e Tasit, kisha e Zografit, e tjerë.

Në regjistrimet e vitit 1519, fshati Hondisht kishte 3 familje, ndërsa në vitin 1583 kishte 26 familje, nga këto 17 kristiane dhe 9 myslimane. Në Hondisht ka pasur kisha dhe më e madhja ka qenë ajo që quhej Shën Gjergji i Hondishtit. Para vitit 1990 ka pasur mbi 150 shtëpi, më vonë filloi migrimi, se mungon rruga automobilistike, mjeksia, arsimit. Tani është zvogëluar me 30 shtëpi dhe fshati jeton kryesisht me blegtori.

**DISA KUJTIME NGA FSHATI SHENEPREMTE**

Nga fshati Shenepremte ishte bijë nusja e Asllan Çelës. Rridhte nga një familje e madhe patriotike, dhe me influencë të madhe. Isha 12-13 vjeç dhe më dërgon mua dhe bashkë me Kadri Lushkën për ta marrë, se kishte shkuar me pushime tek prindrit. Kur vajta atje pashë një shtëpi të bukur, me tradita, me pasuri. E vërta ishte se në oborr ishte një gur me tre shkallë. Ishte guri që u hipnin kuajve gratë e kësaj shtëpie. Ishte shtëpi e pasur, brenda e trishtuar, kur pashë gjash-të-shtatë gra të veshura me të zeza. Pashë Shajen, nusen e Asllanit, e cila më mori më përqafoi, pas darke më vuri të fle në një dhomë të veçantë.

Në këtë shtëpi atë natë erdhën dy burra të tjerë, morëm vesh se ishin Behar Shtylla e Medar Shtylla, për të marrë hallë Shajen. Kishin kuaj të mëdhenj.

Në mëngjes erdhi Muhamet Beu, u ngritëm në këmbë dhe ai u fut në dhomë. Më pyeti mua për herë të parë. Si është Alush Çela?, Ç kemi nga Velçani? Disa pyetje ironike, atje është qendër komune, Velçani qendër e Mokrës. U përgjigja “se sa këlyshë ka vënë në detyrë fashizmi, të gjithë janë gomarë,.. Nga kjo përgjigje u çuan të gjithë, Muhamet Beu ngeli i ngrirë nga përgjigja ime, dhe doli nga dhoma. U nisëm nga Shenepremtja për Velçan, zgjati rreth 12 orë. U kthym, unë nuk i tregova Alush Çelës. Por për darkë qëndroi Kadri Lushka dhe i kishte treguar si për ngjarjen, dhe përgjigjen që i ktheu Haliti beut. Me të marrë vesh këtë, Alush Çela erdhi në dhomën time, e më zgjoi dhe më tha ma trego ngjarjen. Por unë i thashë le të ta tregojë Kadri Lushka. Përgjigja e tij ishte pozitive, mirë ja ke bërë. Ai ishte lidhur me fashistët. Halit ÇELA

# Dhimbje, repekt, mall për Misto Markon

Nga Tomi MATO

**N**jë ditë vjeshte, vitin e kaluar, u takuam me Dr. Miston. Morëm shtypin. U ulëm në klubin buzë liqenit. Ditë e bukur. Rrezet e diellit ruanin akoma afshin e ngrohtë të verës. Liqeni kishte rënë në gjumë. Plazhi kishte akoma mysafirë. Natyra kishte veshur petkun e verdhë. Nga plepat këputeshin fletë dhe duke valëzuar në ajër binin mbi kuvertën e liqenit. Místua vazhdonte të shikonte shtypin. Mua më tërhoqi gulçimi i motorit të peshkatarëve që po kalonin anës bregut. Varka çante ujin dhe krijonte vorbullat prapa. Nga zhurbavitja e liqenit u krijuan valë të lehta. Ato, duke u turrur njëra pas tjetrës, merrnin përpara fletët e plepave, i nxirrnin jashtë, prapë i thëthinin e i fushin në liqen. Dukej sikur luanin. Në një moment i thashë Mistos:

- I shikoj si nxjerrin valët fletët e plepit dhe them: „kur plepi gjelbëron ta kënaq shpirtin, tani që është rrjepur asnjëri nuk e shikon“. Ai treti shikimin në drejtim të plepit, kur pa një fëmijë që po këpuste një trëndafil të kuq, dhe po e sodiste me kërshtëri. Zgjati dorën. Këshilloi:

- Shikoje, fëmija deshte të këpuste trëndafilin. Ia shpuan dorën gjambat. Nga inati i ra me shkëlqim. Trëndafilin i ranë petallet. Nga inati po i shkel me këmbë. Ashtu si trëndafilin kur çel e zbkuron natyrën, kënaq kalimtarët me aromën e tij dhe zhduket pa lënë gjurmë, dhe njeriu këtë fat ka: lind, mëson, shërben, jeton, plakët, sëmuret dhe humbet sikur s'ka jetuar“. E kundërshtova me të qeshur:

- Misto, njeriu lë gjurmë të mira dhe të këqija. Ja, ti, si mjek dhe dramaturg, ke lënë gjurmë. Breat që do të të zëvendësojnë, do të të kujtojnë. Trëndafilin s'e kujton njeri“. Thuaj që gëzon shëndet si në moshën e rinisë. M'i hodhi sytë me kërshtëri. S'ishte dakord. Më kundërshtoi:

- Meta i di hallet e veta. Kohët e fundit kanë filluar të më merren mendtë, humbas ekuilibrin e trupit, harroj, duket do të më zërë sëmundja e sklerozës. Sëmundje e keqe. Mbrëmë ndalova akrepat e orës, hodha sytë e mendjen në kohë e hapësirë, e kalova si në ekran të televizorit kalvarin e jetës sime 35 vjeçare në shërbim të popullit. S'mbaj mend të kem fjetur një natë rahat. Më thërrisnin në spital, nëpër shtëpia, nëpër fshatra. Gjithnjë në shërbim të popullit... I kërcëva në fjalë:

- Ke bërë ndonjë studim se sa njerëz ke shkëputur nga thonjtë e vdekjes? Vuri buzën në gaz dhe ma dha përgjigjen:

Si ay budallai, mora një herë regjistrat e pashë vitin 1967 - kisha vizituar 20 mijë pacientë. Më duket se vdekja, nga inati që i kam shkëputur memijëratë sëmurë nga kthetrat, tani në pleqëri kërkon të ma marrë hakun“. Buzëqeshëm të dy. Për t'ia mbajtur në gazin e humorit, thashë:

- Vdekja të marrë dushmanin, jo ty dhe mua. Kamerierja na solli kafetë. Uroj: - Ju bëftë mirë“. Sa filluam t'i rrufisim, vjen në tavolinë një i panjohur... Dr. Mis-



Dr. Misto, Tomi Mato, Anastas Kostandini

tua? I befashuar iu përgjigj: Po. Kujtoi se mos i kërkoni ndihmë mjekësore. Po, si e keni hallin? Dhe me një mirënjohje të skajshme pyeti:

- Më njihni mua? E pa nga këmba te koka dhe tha:

- Për herë të parë ju shikoj, shoku qytetar. Ai e sqaroi:

Jam fshatar, Zoti doktor. Nga Zagorçani. Mbrëmë nëna më tha: „Mor bir, të bëj rixha, nuk dua të marr gjynah në botën tjetër. Po të mos ishte doktor Místua, nuk do ishte bërë kaq i madh. Do kishe vdekur“. Pse, si është puna, moj nëno?“. Ajo më kallëzoi: Kur ishe i vogël, duke ngrënë përshesh me llallë, kapërceve lugën e hekurit në bark. U enjte. Kishe dhimbje. Gjithë natën qaje. Një burrë i tha babait. Çojeni në Korçë, t'ia çajni barkun, se të vdiq djali“. E thirrëm doktor Miston dhe ai erdhi, e vizitoi dhe na siguroi: „Djalin mos e lëvizni se do t'ia nxjerr unë nga poshtë!“ E ti ma kishe nxjerrë pa ma çarë barkun. Unë jam ai fëmija. Tani jam bërë burrë. Me vonesë, por më mirë vonë se kurrë, erdha t'ju falënderoj. Do të merrni nga unë diçka. E falënderuam dhe, si iku, pyeta doktorin:

- Është kënaqësi shpirtërore t'ju falënderojnë pacientët, aq më tepër pas kaq vitësh!

Ai ma ktheu me një ndjenjë trishtuese:

- Mjekësia më lodhi shumë në jetë. Pasojat e saj po i ndjej tani.

- Nuk isha dakord me të, me mendimin e tij:

- Misto, si dajo Mitrushi edhe ti ke mbajtur nën sqetull dy kunguj. Dajua i diplomuar „Dr. i shkencave ekonomike“, me vlerësimin më të lartë, e krahas detyrave ekonomike, la gjurmë të pashlyeshme edhe në lëmin e letrave. Ndërsa ti, krahas detyrës së mjekut, u more edhe me dramaturgjë. Ngarkesë e madhe psikologjike!

Ai më dëgjoi me vëmendje, tundi kokën lart e poshtë e pastaj tha me zë të ulët:

- Ke të drejtë!

Prej kohësh më shqetësonte

ideja sikur Místua (Mirosh Markaj) t'ia kishte kushtuar jetën dramaturgjisë, do të kishte lënë për brezat, veçanërisht në gjininë e dramës dhe historike, vepra të mëdha artistike. E pyeta:

- Meqenëse Mitrushi e nxori librin „Netë shqiptare“ (me tetë rrëfenja) më 1938, ti kishe mbaruar filloren, me siguri e lexove“. Ai pohoi me kokë.

- Ndoqe gjimnazin francez të Korçës, e më vonë liceun në Tiranë, u njohe me letërsinë botërore, vazhdove të lexojë dhe krijimet e dajos: „Ago Jakupin e të tjera rrëfime“, „Kapllan Aga i Shaban Shpatës“, tregime, vjersha, poema, novela“? Kërcevi menjëherë.

- Të gjitha i lexoja. M'i jepte dajua. Fjalë e muhabet vazhdova:

- Po vetë fillova t'i hedhësh në letër emocionet e para të kohës së rinisë“?

- I brengosur më informoi:

- Po, kur mbarova shkollën e mesme, kisha mësuar frëngjisht, italisht, greqishten e vjetër dhe gjuhën latine. Për herë të parë përktheva prozë të autorit turk Rifki Ata dhe autorit francez Alfonso Dode. I kam botuar në revistën „Bleta“ dhe gazetën „Bashkimi i Kombit“. Më vonë botova skica letrare në revistën „Letrari i ri“. Ndërhyra me kërshtëri:

- Pate sukses në krijimet e para?

- Pata. Më bëri përshtypje, kishte shfrytëzuar dhe ishte frymëzuar nga autorë të huaj. E pyeta:

- Misto, Rilindja Shqiptare nxori në dritë disa shkrimtarë e poetë të shquar si: Naim Frashëri, Kristoforidhi etj., pse nuk shfrytëzove autorët e vendit por u mbështete tek të huajt?

- Ai ngriti dorën. Më dha të drejtë.

- Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së poetit ton të madh, Naim Frashëri, shkrova poezinë „Të paskësh rrojtur 100 vjet“. (Në vitin 1946). Këtë poezi e recitoja nëpër shkollë dhe festa jubilarë. Pata sukses.

Pastaj t'u akordua e drejta e studimit për mjekësi në Beograd,

apo e kam gabim?

- E ke mirë. Mbas një viti u ktheva në atdhe - ndryshoi politika. Shkova për studime në Bukuresht për mjekësi. Mbarova në vitin 1953 dhe u ktheva nga studimet.

Meqenëse filluam të lërojmë në tokën e vendit, vazhdova ta zhbijoj:

- Misto, të rrimë shtrembër e të flasin drejt, jeta artistike si në Beograd e Bukuresht ishte më e pasur se në Tiranë? Apo e kam gabim? I vendosur tha:

- E ke mirë. U ktheva përsëri në temë.

- U azhurnove me jetën skenike në Beograd e Bukuresht? Trego të vërtetën.

- Në Beograd e dija gjuhën, ndërsa në Bukuresht, u njoha me drejtorin e Teatrit Kombëtar, Boboshtarin e njohur, artistin e madh Viktor Eftimiun. Jo vetëm repertorin e Teatrit Kombëtar, por edhe repertorin e teatrove të tjera i ndiqja. Dramaturgjia më pëlqente shumë. Kur erdha në Pogradec, përktheva dramën e Karaxhales „Natë e stuhishme“.

Kjo pjesë u vu në skenë nga trupa amatore e Pogradecit. Ti ishe në Pragë. Doli me sukses. Vazhdova të gërmoj më tutje:

- Vazhdove të merresh me krijimtari letrare? E kam fjalën, t'i ngjaje Dajos“?

Më kujtoi, vuri buzën në gaz dhe vazhdoi.

- Botova në gazetën „Rinia“ shkrimin „Përmes Mokrës“ dhe revistën „Korça e re“, dramën „Guri i hekurit dhe mokrat e gurta“. Dajua m'i lexoi që në dorëshkrim. Më përgëzoi. Kur u botuan, më dërgoi dy letra. Më inkurajonte, dhe unë, paralel me detyrën si mjek i përgjithshëm, gjithë kohën e lirë ia kushtoja krijimtarisë.

Kisha një anktë në shpirt, vendosa t'ia thosha, mbasi të mirëinformohesha, mbi krijimtarinë e tij dramaturgjike. Vazhdova të eksploroj më tutje:

- Do kisha kënaqësinë të më tregonit krijimtarinë tuaj dramaturgjike në vazhdim. Si të mirëinformohem, dua të të bëj një pyetje që prej vitësh më ka shqetë-

suar. Me kënaqësi, u përpoq të ma plotësojë dëshirën. Tregoi:

- Në vitin 1963, në revistën „Korça e re“, botova dy drama „Nata e mbramë e verës, agimi i parë i vjeshtës“ dhe „Pushtonjësit“. Në vitin 1966, po në këtë revistë botova poemën „Prej buzës së detit në buzë të liqenit“. Më 1969 në revistën „Ylli“ botova tregimin „Zalloret“, dhe një vit më vonë në revistën „Nëntori“ tregimin „Ikonat e shenjtata“. Epokës së lavdishme të heroit legjendar Gjergj Kastrioti Skënderbeu“ i kushtova trilogjinë të ndarë në tre pjesë: 1- Gjergj Kastrioti; 2- Pabesia; 3- Qëndresa. Këtë vepër e paraqita në konkursin kombëtar dhe fitova çmimin e parë. (Vazhdojmë Tomi, meqenëse do t'i përsëris. Mbaj shënime siç e ke zakon).

Në vitin 1974 shkrova libretin e operës „Zgjimi“. Kompozitori i njohur Tonin Arapi e kompozoi. U vu në skenë nga TOB. Kjo vepër u vlerësua me çmim të tretë. Kompozitori Çesk Zadeja dhe Tonin Rrota më 29 korrik 1976 shkruan një artikull në gazetën „Drita“. Krahas dramave shkrova dhe komedinë „Vizita e miliarderit“. E vuri në skenë estrada jonë profesionale. (Pushoi. Kujtova se përfundoi informacioni.) E pyeta: Sikur ke dhe vepra të tjera? Si me të qeshur, ma dha përgjigjen:

- Prit të marr fjomë. U lodha. Vazhdoi.

- Në vitin 1978 shkrova dramën „Besa e Madhe“ me rastin e 100 vjetorit të „Lidhjes Shqiptare të Prizrenit“. U vu në skenë në Teatrin Popullor në Tiranë dhe Prishtinë. U prit shumë mirë. Shtëpia botuese „Rilindja“ e botoi si libër. Vazhdojmë në vitin 1982, së bashku me Ruzhdi Pulahën“ shkrojmë dramën „Udha e Flamurit“, kushtuar trimit kosovar Isa Buletini. U vu në skenë e Teatrit Popullor.

Përsëri m'u duk sikur i vuri pikë krijimtarisë. E dinja situatën, ndaj e ngacmova:

- Misto, nga viti 1982, kohën e diktaturës dhe mbas përmbajtjes së saj, në s'gabohem, deri në prag të ndërrimit të shekujve, sikur bërë pauzë të gjatë? Jo vetëm unë, por edhe intelektualët e tjerë prisnin nga ty të përjetësoje miqësinë e ngushtë që kishe me Lasgushin dhe veçanërisht vlerat artistike të Dajos. Të rehat që ai i dha letërsisë moderne shqiptare. Ta kam treguar revistën prestigjioze „Letërsia Evropiane“. Kishte botuar rrëfime nga pena e Mitrush Kutelit. Ti sikur u mënjanoje. Është apo jo e vërtetë?

- Ke të drejtë. Gjatë kësaj kohe punoja në shtëpi. Shkrova dhe botova romanin „Një idil i këputur. Deri në vitin 2009 jam marrë me krijimtarinë“.

E ndërpreva dhe kërkova:

- Kur të kam provokuar: Misto, unë kam shkruar disa material në gazetën „55“ kushtuar dajos, Mitrush Kutelit, më ke lavdëruar, por kur të jam lutur „ti e njehtë mirë dajon, pse nuk shkruan“, më je përgjigjur... të kujtohet...?

- Ke të drejtë. Të dy i kam njohur dhe për të dy kam shumë mbresa të paharruara. Ia vlen t'i njohin brezat e ardhshëm. Do shkruaj patjetër.

Përsëri e ngava:  
 - Prapë nuk shkrove as për Lasgushin, as për Kutelin?  
 Ngriti dorën. Kujtova....  
 - Dajua, Mitrushi, në testamentin që i la Eftëpit (gruas) i thotë: „Askush të mos i prekë dorëshkrimet para se të më rritet djali! I vini në arkë, i mbyllni!  
 Jam kurioz të di - kur ishte gjallë - i jepje Dajos dramën për t'i lexuar dhe a bënte vërejtje?  
 - Mitrushi, veç përshkrimet që i qëndis me kaq vërtetësi e origjinalitet, veçanërisht dialogët dhe monologët i kishite konçiz, me nëntekst logjik - pak fjalë shumë mendim.

- Më ke treguar disa vepra dramatike të shkruara sipas stilit të antikitetit, „Eskilit, Europidit, Sofokliut, (monologë të gjatë 5 - 6 faqe), i kujtoj, në rast se gaboj, më korrigjo. Ke shkruar dramën: 1- „Genti - mbret i ilirëve“; 2- „Pal Emili dhe përse Filipi“; 3- Lak Filipi në Pelion“; 4- „Ngjarje e përgjakshme në Ilirishtë“; 5- „Shëptëpia në greminë“. Pos këtyre, më vure në dijeni se po përgatit një përmbledhje me poezi të shkruara në kohëra të ndryshme. T'i thashë mire! Ma shtërngoi dorën. M'u lut:

- Tani më thuaj, çfarë brengje ke që s'ma ke thënë? Thuama siç e mendon?

Vendosa t'ia thosha siç e kisha menduar prej kohësh.

- Vetë e pohove, se që në moshë të re, tregove se ke talent nga dajua, pse nuk ia kushitove këtë talent letërsisë, por ia kushitove mjekësisë? Zuri kokën me të dyja duart. U trushit. U tremba. Thashë: Më fal, Misto, pa dashje“. Hoqi duart, gulçoi

dhe nxori ankthin:  
 - Tomi, letërsia ka qenë ëndrra ime. Alli nuk deshte ...“. E ndërpreva: Dajua?

- Nëna. Kur thashë se do kërkoj të drejtë studimi për letërsi, m'u hodh në grykë. Klithi si e lajthitur: „Ç'ke ndërmend, të heqësh të zitë e ullurit si vëllai i motrës!“. Atje tek mulliri i tit eti të shkosh, e për letërsi, kaq ta bësh dhëmbin, s'të dërgoj!“. Kjo ishte arsyeja, mos ma kujto ...

Ky ishte takimi I fundit që bëra me Misto Markon tek lokali, buzë liqenit, për të nxjerrë ankthin që kisha, pse s'ia kushitoi jetën dramaturgjisë ...

Para se të ikte në Amerikë e vizitova me dy intelektualë të njohur të qytetit, Anastas Kostandinin (Piktor i merituar) dhe Gjergji Lakon (Piktor i shquar). I uruam shëndet, të na kthehet sa më shpejt shëndoshë. U shua larg atdheut, larg Pogradecit e pogradecarëve që e deshën aq shumë; larg shokëve e miqve; larg varreve të fisit, nënës, babës, dhe vëllezërve. Për Miston do na zërë malli. E deshëm dhe na deshte. E kishim shok të mençur.

Mistua dha një kontribut të madh për emancipimin e kulturës qytetare, si në shëndetësi, art e kulturë. Ishte doktor, shkrimtar i shquar dhe qytetar shembullor. Në emër të miqve të tij, do t'i lutemi Zotit që shpirtin e tij ta vendosë në parajsë. Ne, miqtë e tij, do ta kujtojmë me dashuri dhe nostalgji. Me fjalë të drithëruara, dhimbje, mall e dashuri, „Vemë“ e vendosim një kurorë mirënjohje mbi gjoks, larg në Amerikë, ku prehet në gjumin e përjetshëm.  
 Pogradec, më 18.09.2010

# Lufta civile në Dunicë të Pogradecit - 7 Mars 1944

**K**a shumë njerëz që duan të jenë si historianë për të shkruar të vërtetën e vërtetë se ç'ka ndodhur në Shqipëri gjatë viteve 1943-'44 në kohën e luftës civile, gjatë kësaj periudhe që shqiptari vrau shqiptarin nën thirrjen e rreme se po luftojmë fashizmin.

Të gjithë tashmë e dimë se pjesa e shqiptarëve e udhëhequr nga mugoshët e popoviçet kishin marrë urdhër që ku të hasnin nacionalistë të shtinin pa hezitim. Në shumë raste është shkruar për masakrat e kryera në çdo kënd të Shqipërisë gjërat janë zbardhur deri diku. Në disa raste ka pasur mungesë të dokumentacionit e në disa raste të tjera ka munguar dëshira për t'u thënë e vërteta pasi një pikë errët nuk duhet të zbardhet.

E kam fjalën për Uran Aliçkën që kërkon të bëhet historian medoemos, por kursesi për të shkruar për Dunicën. Uran mirë bën që shkruan për babanë e tij, por mundohet të fshehtë xhaxhain e tij, Muharremin. Dunica rënkon, loton e kërkon sqarim. Uran Aliçkës i dridhet dora të shkruajë të vërtetën. Pse? Pas 1944, kur Shqipëria u

**AKT - AKUZE**  
 Bot më 9 Maj 1945, Komisioni Hetues për shulimin e krimet dhe kriminelëve të luftës dhe armiqet të popullit, i formuar rejt:

Kryetar (Gjyqtar)	Anëtar. Përcaktues i Frontit N. G.
1) Mihallog penasi	" " " " "
2) Gëzo Nasto	" " " " "
3) Shënkoz Villa	" " " " "
4) Miha Leko	" " " " " Përshtetit.
5) Muharem Butka	" " " " "
6) Nesir Karafil	" " " " " Usktrisë.
7) Faço Nadell	" " " " "
8) Hovrija Pojani	" " " " " Grana A.P.
9) Alako Veshti	" " " " " Rinis A.P.

Mori në shqyrtim aktet hetimore të të pandehurit Luman Mustafara bir' i Mustafajt dhe i Kaçe Halimit, lindur e banues në katundin Sel bujk, vjeç 45, i reshtuar më .....

pushtua nga bandat e kuqe terroriste vazhdoi lufta civile, por në një mënyrë tjetër, me anë të "gjyqeve të popullit" që vrisnin. Në këto gjyqe të sajuara, ku xhaxhai i Uranit ishte anëtar, një nga komunistët e parë, përdorte vetëm fjalën litar ose kur ngatërrohej përdorte fjalën pushkatim. Asgjë nuk e dallon Muharrem Butkën, këtë anëtarë gjykate nga kriminelin Josif Pashko të cilin e njohin të gjithë për bëmat e tij. Në një rast kriminelin Josif Pashko dha 27 vendime me varje, të tjerët me pushkatim. Anëtarët e tjerë të

trupit gjykues i thoshin: "Shoku Josif, nuk janë 27, por 21 ata që do t'i varim." Josifi i jargavitur dhe i shkumëzuar nga "zemërimi e hakmarrja" u çor duke ulëritur: "S'ka gjë se janë më pak, do sjellin të tjerë për t'i vrrarë."

Për disa nga këto gjyqe po paraqesim trupin gjykues. Po ashtu po ju paraqesim një listë të disa të vrrarëve në luftën civile të Dunicës. Në numrin tjetër do t'ju bëjmë të njohur listën e të pushkatuarve pas vitit 1944.

Në faksimilen e mëposhtme po ju paraqesim trupin gjykues, ku bënte pjesë Muharrem Butka.

## Emrat e të pushkatuarve në Dunicë

Nr	Emër Mbiemër	Data e pushkatimit - vendlindja
1	Haki Blloshmi	7 mars 1944 - Bërzeshtë
2	Shefqet Blloshmi	7 mars 1944 - Bërzeshtë
3	Sabri Blloshmi	7 mars 1944 - Bërzeshtë
4	Bajram Blloshmi	7 mars 1944 - Bërzeshtë
5	Lim Bishtogu	7 mars 1944 - Bërzeshtë
6	Rexhep Leka	7 mars 1944 - Bërzeshtë
7	Isuf Face	7 mars 1944 - Farretë
8	Elmaz Belba	7 mars 1944 - Skroskë
9	Refat Belba	7 mars 1944 - Skroskë
10	Shaqir Belba	7 mars 1944 - Skroskë
11	Nuredin Uzuni	7 mars 1944 - Skroskë
12	Met Çepi	7 mars 1944 - Xhyrë
13	Sabri Elezi	7 mars 1944 - Stravaj
14	Must Qorri	7 mars 1944 - _____
15	Halim Spaho	7 mars 1944 - Debrovë
16	Shaban Leka	7 mars 1944 - _____
17	Adem Kapri	7 mars 1944 - Golik
18	Dervish Çela	7 mars 1944 - _____
19	Xhelo Selca	7 mars 1944 - _____
20	Rakip Selca	7 mars 1944 - _____
21	Bajram Trebinja	7 mars 1944 - _____
22	Sadik Turtulli	7 mars 1944 - _____
23	Qani Turtulli	7 mars 1944 - _____
24	Shaban Guçe	7 mars 1944 - _____
25	Ilmi Likollari	7 mars 1944 - _____
26	Refat Mehmeti	7 mars 1944 - _____
27	Shebi Likollari	7 mars 1944 - _____

## LISTA E DISA TË PUSHKATUARVE NË RRETHIN E POGRADECIT GJATË REGJIMIT KOMUNIST:

- |    |              |    |   |
|----|--------------|----|---|
| Nr | Emër Mbiemër | 15 | Adem Çela                                       |
| 1  | Njaz Muço    | 16 | Sami Çela                                       |
| 2  | Jaup Muço    | 17 | Dervish Çela                                    |
| 3  | Xhevit Muço  | 18 | Rushit Çela                                     |
| 4  | Arir Muço    | 19 | Demir Spaho (Vdekur ne hetuesi gjatë torturave) |
| 5  | Irfan Muço   | 20 | Hatja Q.....                                    |
| 6  | Hasim Muço   | 21 | Qemal Doçe                                      |
| 7  | Gani Muço    | 22 | Shefki Kreka                                    |
| 8  | Emin Lena    | 23 | Muharrem Pengu                                  |
| 9  | Izja Muço    | 24 | Pelivan Muçi                                    |
| 10 | Luftar Muço  | 25 | Gani Besholli                                   |
| 11 | Shaban Guçe  | 26 | Zyhdi Lipe                                      |
| 12 | Bajram Muço  | 27 | Maliq Avdullahu                                 |
| 13 | Hodo Agolli  | 28 | Klime Petre                                     |
| 14 | Isuf Çela    |    |   |



- 29 Sallten Manellari
- 30 Vehbi Mehmetaliu
- 31 Baki Pero
- 32 Tafil Kume
- 33 Shahin Bitollari
- 34 Ismail Meçe
- 35 Kurt Topi
- 36 Sallten Dervishi
- 37 Xhezar Toska
- 38 Dehar Oshafi
- 39 Kiço Budo
- 40 Nuri Xhydollari
- 41 Ali Pasha
- 42 Avdulla Alaruçi
- 43 Saip Alaruçi
- 44 Tefik Muçollari
- 45 Tefik Sadikaj
- 46 Ilmi Berberi
- 47 Lutfi Çami
- 48 Reshit Berberi
- 49 Hasan Manellari
- 50 Mazllëm Lamçe

Në rrethin e Pogradecit kanë qenë këto vend-pushkatime:

- 1) Lumi i Tërhanit
- 2) Xhamia e qytetit
- 3) Gështenjat e Pogradecit
- 4) Përroi i varrezave
- 5) Kodra e kundërajrorëve
- 6) Luadhi i Çelos

Përgatiti Bedri BLOSHMI

# KALI I PROPTISHTIT SHKON NË STAMBOLL

Nga Ismail LEKA



**N**ë Xhyrë kemi një mik prej 5-6 breza sh, këtë e mbajmë prapë tani. Është një histori reale në kohën e Turqisë, në shekullin e 19-të. Një kushuriri jonë, nga fisi Leka i fshatit Proptisht shkon emigrant në Stamboll, atje fillon punë në ndërtim, dhe natyrisht pa asnjë lloji dokumenti.

Gjatë punës në ndërtim pas një kohe ai u aksidentua në gju, dhe nuk levizte dot, u shtrua në spital, por nuk kishte financim për t'u kuruar. Këtë e mori vesh një burrë nga fisi Xhyra, nga Librazhdi, i cili kishte kohë që jetonte në Stamboll, dhe ky shkon e viziton. I thotë doktorit që ta bëjë operacion dhe ta kurojë, sepse për finacimin do të përgjigjem unë. Ky kurim bente 260 napolona flori, mirë nuk ka problem, dhe urdhëroni 260 napolonat e folririt, njëkohësisht i jep edhe 40 napolona që të hante ushqim të mirë, e për një shërbim më të mirë mjekësor. Emigranti nga Proptisht nuk i pranoi këto napolona që i dha bashkëatdhetari nga Xhyra. Po dashamirsi nga Xhyra pasi e dëgjoi i tha unë t'i kam dhënë të shërohesh dhe t'i kam falur, unë të takoj çdo ditë, e të çmallem me vendlindjen. Unë nuk do ti jap për ti kthyer. Do të shërohesh, gjuri do të lëviz. Napolonat ti dhashë për muhabet jo për t'mi kthyer prapë. Në këtë mënyrë u bëmë miq të mirë, dhe shumë të

rregullt. Pas disa vitesh ai vjen në Xhyrë, dhe bën një vizitë në Proptisht. Në këtë vizitë kishtë për qëllim të blinte një kalë me shaël, të bukur, të shkathët, që këtë të mos e kishite njeri në Stamboll. Por nga sa kërkoi në Xhyrë nuk i pëlqyen dhe nuk gjeti një kalë si e donte vetë. Në vizitën që bëri në Proptisht, i pëlqeu një kalë nga fisi Leka. Ishte kalë i bardhë, i bukur dhe i lartë. Pyet, kush e ka atë kalë?. I doli i zoti dhe e pyeti se sa lekë të bën, për ta blerë. Ai ishte nga fisi Leka dhe ju përgjigj se ai kalë nuk ka çmim. Ai jepet dhuratë vetëm për juve. Ju nuk mund të çlyheni për nderin që më keni bërë. Ju më keni shëruar kushuririn tonë në Stamboll.

Kali i dhurohet nga fisi Leka. Ai e merr dhe ja dha një zantçiu për t'i bërë një shaël të bukur, e sat ë bëjë. Pasi i vuri shalen e mori dhe u nda nga fisi Leka. Me këtë kalë unë do të shkoj në Stamboll dhe atje shkoi.

Tani e kësaj dite ne jemi miq nga 5-6 breza larg, nuk jemi në gjak. por kemi një miqësi, të rregullt, shkojmë e vimë tek njëri tjetri. Pra ja vlen të keshë një mik të tillë. Ne për çdo gjë, kemi lidhje të rregullta dhe miqësore.

